

|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komunë e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-419/2021</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>28.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i Kanalizimit në Drogolevc”; Lot2 “Ndërtimi i Kanalizimit në Saradran”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-4300-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-033-521, nxjerr:

### V E N D I M

**1. FORMOHET:** Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i Kanalizimit në Drogolevc”; Lot2 “Ndërtimi i Kanalizimit në Saradran”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-4300-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-033-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Naser Nimanaj,** Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Dukagjin Hoxhaj,** Zyrtar për Regjistrim të Adresave, anëtar dhe
- 1.3. Blerim Bujupi,** Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar.

**2.** Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i Kanalizimit në Drogolevc”; Lot2 “Ndërtimi i Kanalizimit në Saradran”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

**3.** Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

**4.** Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

**5.** Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor brenda 24 orëve të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit të kenë qasje në ofertat e operatorëve ekonomik që kanë shprehur konkurrencë.

**6.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



**Kryetari i Komunës**  
**Haki RUGOVA**

|                                                                                                                                                    |                                                                                    |                               |                                                                                                                                               |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSIEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-416/2021                                                                 | Data:<br>Datum:<br>27.07.2021 |                                                                                                                                               |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Drejtorisë për Administratë Komunale, e qe ka te beje me vazhdimin qëndrimit në pozitën e punës të z.Arlind Balaj, zyrtar për Gjendje Civile 1, dhe nxjerr:

### V E N D I M

1. **z. Arlind Balaj:** tani i sistemuar në punët dhe detyrat e: Zyrtar i lartë ligjor për Financa, për shkak të volumit të madhe të punëve dhe mungesës së stafit përkatës në gjendjen civile, do t'i kryej, punët dhe detyrat e zyrtarit për gjendje civile 1, e të cilat i ka kryer edhe më parë.
2. I lartpërmenduri ka filluar nga data 21.07.2021 dhe do të vazhdojë ushtrimin e detyrës së mëhershme deri në fillimin e muajit Shtator, përkatësisht deri në zvogëlimin e fluksit dhe përfundimin e pushimit nga mërgimtarët, si dhe do t'i kryejnë punët dhe përgjegjësit tjerë të cilat janë në natyrën e këtij.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit të tij dhe fillon të zbatohet menjëherë nga Drejtoria për Administratë Komunale.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Arlind Balaj**, Drejtoria për Administratë komunale, dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.


**Kryetari i Komunës**  
**Haki RUGOVA**

|                                                                                                                                                                         |                                                                                   |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br.01-415/021</b>                                                           | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>27.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim shqyrtoi kërkesën: Nr.10-400-17886, të datës 24.05.2021 të parashtruar nga OJQ "Vision 02" nga Gurrakoci të cilën e përfaqëson Rexhë Mulaj, për përkrahje me karburant për nevojat OJQ-së, për realizimin e projektit: "Bashkëpunimi ndërkuftar për zhvillimin e raundit të parë të shkollës verore për zhvillimin e aktiviteteve multietnike- multikulturore dhe tradicional" dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

#### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.10-400-17886 e datës 24.05.2021 e parashtruar nga OJQ "Vision 02" të cilën e përfaqëson Rexhë Mulaj, për përkrahje me karburant për nevoja të "OJQ-Vision 02" për realizimin e projektit: "Bashkëpunimi ndërkuftar për zhvillimin e raundit të parë të shkollës verore për zhvillimin e aktiviteteve multietnike- multikulturore dhe tradicional" në Durrës aktivitetet do të realizohen 5 ditë në Republikën e Shqipërisë dhe përkrahet me **350 litra karburant**.
2. Obligohet Zyrtari i Transportit "OJQ-Vision 02" të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtar.

#### A r s y e t i m

OJQ "Vision 02", ka parashtruar kërkesën Nr.10-400-17886 të datës 24.05.2021, për përkrahje me karburant për nevoja të OJQ "Vision 02" për realizimin e projektit: "Bashkëpunimi ndërkuftar për zhvillimin e raundit të parë të shkollës verore për zhvillimin e aktiviteteve multietnike- multikulturore dhe tradicional" në Durrës, aktivitetet do të realizohen 5 ditë në Republikën e Shqipërisë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e OJQ "Vision 02" dhe të njëjtat i konsideron të arsyeshme dhe i miraton.

Duke parë rendësin e punës së OJQ "Vision 02" për realizimin e projektit: "Bashkëpunimi ndërkuftar për zhvillimin e raundit të parë të shkollës verore për zhvillimin e aktiviteteve multietnike- multikulturore dhe tradicional" në Durrës, aktivitetet do të realizohen 5 ditë në Republikën e Shqipërisë, OJQ "Vision 02" ka kërkuar mjete financiare në shumë prej 500.00€, por në mungesë të mjeteve financiare e përkrahet me 350 litra karburant për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Zyrtari i Transportit do të pajisë me vërtetim për furnizim me karburante të lartpërmendurit nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Shefi i Autoparkut kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Rexhë Mulaj, Zyrtari i Transportit, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim** dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**

*[Signature]*

Kryetari i Komunës  
**Haki RUGOVA**

*[Signature]*



|                                                                                                                                                    |                                                                                   |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSIEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-412/21                                                                  | Data:<br>Datum:<br>26.07.2021 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe kërkesës së Drejtoris Komunale të Arsimit në Istog të cilët kanë kërkuar që ti lejohet shfrytëzimi i hapësirave/oborreve të shkollave për parkimin e automjeteve për bashkatdhetarë, merre këtë:

### V E N D I M

1. **APROVOHET** : rekomandimi i Drejtoris Komunale të Arsimit në Istog, të cilët kanë kërkuar shfrytëzimin e hapësirave të oborreve të shkollave si parkingje për bashkatdhetarët pa pagesë.
2. Lejohet shfrytëzimi i oborreve të shkollave nga data 27.07.2021 e deri me datën 30.08.2021, në shkollat si më poshtë:
  - Gjimnazi "Haxhi Zeka" në Istog,
  - ShFMU "Bajram Curri" në Istog

Për implementimin e këtij vendimi do të kujdeset DKA-ja në Istog dhe drejtoritë e shkollave të lartcekura.

#### Vendimi u dërgohet:

Drejtoratit për Arsim  
Stacionit Policor në Istog  
Drejtorëve të Shkollave përkatëse dhe  
Një kopje në arkivin e këtij shërbimi



Kryetari i Komunës  
Haki RUGOVA



|                                                                                                                                                    |                                                                                         |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br.01-411/021                                                                        | Data:<br>Datum:<br>26.07.2021 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën Nr.01-016-28339, të datës 26.07.2021, e parashtruar nga, z.Mirsad Turkaj, nga fsh. Kashicë, komuna Istog, për përkrahje sipas mundësive me karburant, dhe nxjerr:

### V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-016-28339, të datës 26.07.2021, e parashtruar nga z.Mirsad Turkaj, për përkrahje sipas mundësive, dhe i lejohen, 100 litra karburant për transportin e familjareve të dëshmoreve në burgun e Dubraves.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë me vërtetim z.Mirsad Turkaj, për furnizim me karburant, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Administratë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtorisë për Administratë dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

z.Mirsad Turkaj, në pajtim me pajtim me familjet e dëshmoreve ka parashtruar kërkesën Nr. 01-016-28339, të datës 26.07.2021, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet përkrahje me karburant për transportimin e familjareve të dëshmoreve për në burgun e Dubravës me rastin e "Ditës së Dëshmoreve".

Kryetari shqyrtoi kërkesën dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Shefi autoparkut do të pajisë të përmendurin me vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Administratë në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorisë e Shërbimeve Publikë, Mbrojtje dhe Shpëtim, do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Mirsad Turkaj, Drejtorisë për Administratë, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-409/2021</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>20.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-23484, të datës 25.06.2021, e parashtruar nga z.Gani Arifaj, nga fsh.Rakosh, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e djalit te tij, nxjerr:

### V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-553-23484, të datës 25.06.2021, e parashtruar nga z.Gani Arifaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim te djalit, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 250€(dyqindë e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Gani Arifaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

z.Gani Arifaj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-23484, të datës 25.06.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim te djalit.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Dukagjin Arifaj është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Gani Arifaj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Gani Arifaj Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës  
Haki RUGOVA



|                                                                                                                                                         |                                                                                         |                               |                                                                                                                                                |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>+<br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                         | Nr.Br. 01-408/021                                                                       | Data:<br>Datum:<br>22.07.2021 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) në bazë të nenit 38 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 8/2019) dhe bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën 02 Nr.67/2021 të datës 21.07.2021 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, nxjerr:

### V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa 02 Nr.67/2021 të datës 21.07.2021 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, për intervistimin me gojë të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe Monitorim të publikuar me datën 22.06.2021 në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe KVLBK formohet me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. Fadil Kabashi,** Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Fatmir Bytyçi,** Menaxher i Personelit, anëtar;
- 1.3. Valbona Kaliqanaj,** Zyrtare e Lartë për Pemëtari, anëtare;
- 1.4. Abedin Neziraj,** Zyrtar për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komunitete, anëtar
- 1.5. Fisnik Shoshaj,** Zyrtar Ligjor 2, anëtar;

- KVLBK zëvendësues është në këtë përbërje si me poshtë:

- 2.1. Xhavit Idrizaj** Udhëheqës i Sektorit për Pylltari, Kryesues i Komisionit;
- 2.2. Ramë Blakaj** Teknik i Gjuetisë, Pylltarisë dhe Peshkimit, anëtar;
- 2.3. Esad Smakic** Zyrtar për Buxhet dhe Financa2, anëtar;
- 2.4. Jehona Arifaj,** Udhëheqëse e Sektorit për Shërbime me Qytetar, anëtare;
- 2.5. Dukagjin Hoxhaj** Zyrtar për Regjistrim të Adresave, anëtar

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset Komisioni.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni KVLBK-, Komisioni Zëvendësues, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

  
**Kryetari i Komunës**  
**z. Haki RUGOVA**



|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-406/021</b>                                                         | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>19.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-18086 të datës 24.05.2021 e parashtruar nga Jahë Jahaj nga fsh. Zallq, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për shërimin e bashkëshortes Rabe Berisha, nxjerr:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-18086 e datës 24.05.2021 e parashtruar nga Jahë Jahaj nga fsh. Zallq, për ofrim të ndihmës financiare për shërimin e bashkëshortes Rabe Berisha, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 200.00€(dyqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e bashkëshortit Jahë Jahaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

Jahë Jahaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-18086 të datës 24.05.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Raba është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për shërim, i cili shërim është mjaftë i kushtueshëm.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave, ti bëjë kontrollet mjekësore të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor i Zyrës Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Jahë Jahaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Jahë Jahaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**







|                                                                                                                                                    |                                                                       |                                          |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/> PRESDENIK OPŠTINE<br/> MUNICIPAL MAYOR</b> |                                          | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | <b>Nr.Br. 01-405/2021</b>                                             | <b>Data:<br/> Datum:<br/> 19.07.2021</b> |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-1290, të datës 12.01.2021, e parashtruar nga z.Brahim Rexhaj, nga fsh.Cerrcë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

### V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-1290, të datës 29.06.2021, e parashtruar nga z.Brahim Rexhaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Brahim Rexhaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

z.Brahim Rexhaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-1290, të datës 12.01.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Brahim Rexhaj, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Brahim Rexhaj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Brahim Rexhaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës  
Haki RUGOVA



|                                                                                                                                                    |                                                                                        |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSËDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-404/2021                                                                     | Data:<br>Datum:<br>19.07.2021 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-24880, të datës 05.07.2021, të parashtruar nga znj.Sherife Zogaj, nga fsh.Kaliqan, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e saj në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.0-553-24880, të datës 05.07.2021, e parashtruar nga znj. znj.Sherife Zogaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e saj në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore(Kimioterapisë), dhe i lejohen 170 litra karburant, për 6 (Gjashtë)muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë znj.Sherife Zogaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

### A r s y e t i m

znj.Sherife Zogaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-24880, të datës 05.07.2021, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se znj.Sherife Zogaj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e terapisë (kimioterapisë), në QKUK në Prishtinë.

E lartpërmendura nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për ë Prishtinë për marrjen e terapisë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.


Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: znj.Sherife Zogaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
 Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës  
 Haki RUGOVA



|                                                                                                                                                    |                                                                                         |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-403/2021                                                                      | Data:<br>Datum:<br>16.07.2021 |                                                                                                                                                |

|                                                                                                                                                                         |                                                                                 |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PRESEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-390/2021</b>                                                       | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>13.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-23958, të datës 29.06.2021, e parashtruar nga z.Sefadin Mehaj, nga fsh.Gurakoc, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

### V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-553-23958, të datës 29.06.2021, e parashtruar nga z.Sefadin Mehaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 250€(dyqindë e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Sefadin Mehaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

z.Sefadin Mehaj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-23958, të datës 29.06.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Sefadin Mehaj, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaft të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Sefadin Mehaj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Sefadin Mehaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

  
**Kryetari i Komunës**  
**Haki RUGOVA**  


|                                                                                                                                                   |                                                                                         |                               |                                                                                                                                               |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                   | Nr.Br. 01-389/2021                                                                      | Data:<br>Datum:<br>13.07.2021 |                                                                                                                                               |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-25754, të datës 09.07.2021, të parashtruar nga znj.Luljete Curraj, nga fsh.Tomoc, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e nenës së saj në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-25754, të datës 09.07.2021, e parashtruar nga znj.Luljete Curraj, për përkrahje me karburant për dërgimin e saj në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore (Kimioterapisë) dhe i lejohen 150 litra karburant.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë znj.Luljete Curraj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

### A r s y e t i m

znj.Luljete Curraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-25754, të datës 09.07.2021, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se znj.Luljete Curraj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë.

E lartpërmendura nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për në Prishtinë për marrjen e terapisë. Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: znj.Luljete Curraj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arshivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës  
 Haki RUGOVA



|                                                                                                                                                                         |                                                                                   |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-388/021</b>                                                          | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>13.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 58 pika h). të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe nenin 10. paragrafi 5 i Rregullores Komunale për punën e Kuvendit të Komunës së Istogut Nr.2/2013, shqyrtoj kërkesën e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për formimin e komisionit për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, nxjerr:

## V E N D I M

**1. FORMOHET:** Komisioni për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare dhe në këtë komision caktohen:

- 1.1. **Hysni Maxharraj**, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kryesues i Komisioni;
- 1.2. **Osman Sadikaj**, Zyrtar Kryesor Financiar, anëtar;
- 1.3. **Jashar Blakaj**, Drejtor i Drejtorisë, për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar;
- 1.4. **Lulzim Shoshi**, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, anëtar;
- 1.5. **Lulzim Blakaj**, Drejtor i Drejtorisë për Administratë, anëtar;
- 1.6. **Drin Sadikaj**, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar;
- 1.7. **Mujë Osmanaj**, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtar;
- 1.8. **Hajrush Shoshi**, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar;
- 1.9. **Demë Çetaj**, Drejtor i Drejtorisë për Inspeksion, anëtar;
- 1.10. **Enver Rugova**, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe shpëtim, anëtar;
- 1.11. **Hazbi Bajra**, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar;
- 1.12. **Rasim Mahmutović**, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
- 1.13. **Zekije Sutaj**, Udhëheqës e Sektorit Ligjor, anëtare;
- 1.14. **Muhamet Gusturanaj**, Udhëheqës i Sektorit për Integrime Evropiane, anëtar;
- 1.15. **Vjosa Hysenaj**, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunes, anëtare;
- 1.16. **Genc Ademaj**, Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Projekteve për partneritet publiko-privat, anëtar;
- 1.17. **Gani Sylaj**, Zyrtar i Lartë Buxhet dhe Financa, anëtar;
- 1.18. **Avenita Selmanaj**, Zyrtare e Pasurisë, anëtare;
- 1.19. **Idriz Imeraj**, Zyrtar për Logjistikë 1, anëtar;

2. Komisioni do të bëjë hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare; do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e punës për hartimin Projekt-Rregullores të cekur me lartë dhe pas përfundimit një kopje të Projekt-Rregullores do t'ia dorëzojë Kryetarit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe përgjegjësit tjera që janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Komisioni obligohet të filloj me punë menjëherë, të gjitha punët juridike-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryej: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Komisioni, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**

*[Signature]*



Kryetari i Komunës  
**z. Haki RUGOVA**

*[Signature]*



|                                                                                                                                                                         |                                                                                    |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSIEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br.01-387/021</b>                                                            | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>12.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën: Nr.01-016-22434, të datës 18.06.2021; të parashtruara nga “OVL-UÇK” në Istog, për përkrahje me karburant për nevojat e tyre dhe nxjerr:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-016-22434 e datës 18.06.2021 e parashtruara nga “OVL-UÇK” për përkrahje me karburant për nevoja të “OVL-UÇK-së dhe përkrahet me karburant, për muajin Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor, për se cilin muaj me nga 50 litra karburant.
2. Obligohet Zyrtari i Transportit, përfaqësuesin e “OVL-UÇK” të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyra e Kryetarit dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

“OVL-UÇK”, ka parashtruar kërkesën Nr.01-016-22434 të datës 18.06.2021, për përkrahje me karburant për nevoja të këtij Institucioni.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e OVL-UÇK” dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Duke parë rendësin e punës së të lartpërmendurit përkrahet karburant për muajin Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor për se cilin muaj përkrahet me nga 50 litra karburant për nevoja të “OVL-UÇK-së”.

Zyrtari i Transportit do ti pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të lartpërmendurin nga programi buxhetor i Zyrës Kryetarit në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Shefi i Autoparkut kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: “OVL-UÇK”, Zyrtari i Transportit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**

*Zekije SUTAJ*



|                                                                                                                              |                                                  |                               |                                                                                                                          |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|-------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/> PRESDENIK OPŠTINE</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok |
|                                                                                                                              | Nr.Br.01-386 /021                                | Data:<br>Datum:<br>12.07.2021 |                                                                                                                          |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), nenit 4 nënparagraf i2.1. i paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, nxjerr:

### V E N D I M

1. z. Herolind Haskaj, Arkitekt i diplomuar, me vendbanim në fshatin Cerrcë, Komuna e Istogut, emërohet: Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës.
2. Shefi i Kabinetit, i cekur më lartë, do t'i kryejë punët administrativo-teknike, duke përfshirë ofrimin e mbështetjes Kryetarit të Komunës në realizimin e përgjegjësiave të tij; do të aranzhojë dhe njoftoj Kryetarin me takimet të cilat i ka të caktuara, apo takime të ndryshme të cilat do të caktohen nga Kryetari, që janë në natyrën e punës së Kabinetit të Kryetarit.
3. I përmenduri me kryerjen e punëve dhe përgjegjësiave të Shefit të Kabinetit do t'ia fillojë më 12.07.2021 dhe mandati i tij zgjatë sa mandati i Kryetarit të Komunës.
4. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.01/2018 MAPL për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna.
5. Obligohet Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime të pëfshijë të përmendurin në listën e pagave e pagës të fillojë nga data e cekur në pikën 3. Të këtij Vendim, në pajtim me procedurat në fuqi.
6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Menaxheri i Personelit dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: z. Herolind Haskaj Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës  
Haki Rugova



|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br.01-386/021</b>                                                          | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>12.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 nenin 58 pika f) dhe nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe bazuar në nenin 74 paragrafi 74.2 të Statutit të Komunës Nr.62/010 të datës 30.11.2010, për emërimin e Ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, nxjerr:

### V E N D I M

1. **z.Rrustem Gashi**, emërohet Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis me mandat të Kryetarit të Komunës, i cili ka të përfunduar fakultetin e Arkitekturës, me vendbanim në Istog, Komuna e Istogut,
1. I lartpërmenduri punën do të filloj nga data 12.07.2021, do të menaxhoj dhe udhëheq Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mjedis në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës dhe në pajtim me Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
2. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa të bëjë kërkesën në Departamentin e Shërbimit Civil-Divizioni për Paga dhe Mëditje në Ministrinë e Administratës Publike, për vendosjen e të përmendurit në listën e pagave në pajtim me Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **z.Rrustem Gashi**, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**



Kryetari i Komunës  
**Haki RUGOVA**





|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br.01-384/021</b>                                                          | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>12.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 nenin 58 pika f) dhe nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe bazuar në nenin 74 paragrafi 74.2 të Statutit të Komunës Nr.62/010 të datës 30.11.2010, për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, nxjerr:

### V E N D I M

1. **z.Jashar Blakaj**, emërohet Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim me mandat të Kryetarit të Komunës, i cili ka të përfunduar fakultetin e Ndërtimtarisë, me vendbanim në Istog, Komuna e Istogut,
1. I lartpërmenduri punën do të filloj nga data 12.07.2021, do të menaxhoj dhe udhëheq Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës dhe në pajtim me Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
2. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa të bëjë kërkesën në Departamentin e Shërbimit Civil-Divizioni për Paga dhe Mëditje në Ministrinë e Administratës Publike, për vendosjen e të përmendurit në listën e pagave në pajtim me Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **z.Jashar Blakaj**, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**




|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br.01-383/021</b>                                                          | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>12.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 nenin 58 pika f) dhe nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe bazuar në nenin 74 paragrafi 74.2 të Statutit të Komunës Nr.62/010 të datës 30.11.2010, për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Administratë, nxjerr:

### V E N D I M

1. **z.Lulzim Blakaj**, emërohet Drejtor i Drejtorisë për Administratë me mandat të Kryetarit të Komunës, i cili ka të përfunduar fakultetin Juridik, me vendbanim në Istog, Komuna e Istogut,
1. I lartpërmenduri punën do të filloj nga data 12.07.2021, do të menaxhoj dhe udhëheq Drejtorinë për Administratë në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës dhe në pajtim me Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
2. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa të bëjë kërkesën në Departamentin e Shërbimit Civil-Divizioni për Paga dhe Mëditje në Ministrin e Administratës Publike, për vendosjen e të përmendurit në listën e pagave në pajtim me Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **z.Lulzim Blakaj**, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**



Kryetari i Komunës  
**Haki RUGOVA**



|                                                                                                                                                    |                                                                                                                   |                                                          |                                                                                                                                                   |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosovo | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b><br><br>Nr.Br. 01-372/2021 |                                                          | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Municipality of Istog |
|                                                                                                                                                    |                                                                                                                   | <b>Data:<br/>         Datum:<br/>         09.07.2021</b> |                                                                                                                                                   |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 nenin 58 pika f) dhe nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe bazuar në nenin 74 paragrafi 74.2 të Statutit të Komunës Nr.62/010 të datës 30.11.2010, shkarkohet me dorëheqje Drejtoresha e Drejtorisë për Administratë, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Dorëhiqet znj.Edona Bujupi-Loxha** nga emërimi i Drejtoreshës së Drejtorisë për Administratë, me vendbanim në fsh. Gurakoc Komuna Istog.
2. Me datën 09.07.2021 Drejtoreshës së lartpërmendur i ndërpritet marrëdhënia e punës me dorëheqje, pasi që ajo ka shkuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
1. Drejtoria për Buxhet dhe Financa obligohet të bëjë kërkesë në Ministrinë kompetente që Edona-Bujupi Loxha të largohet nga lista e pagave.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Personelit.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: **znj.Edona-Bujupi Loxha**, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Menaxheri i Personelit, dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**

*[Signature]*



Kryetari i Komunës  
**Haki RUGOVA**

*[Signature]*



|                                                                                                                                                    |                                                                                    |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSIEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br.01-371/021                                                                   | Data:<br>Datum:<br>09.07.2021 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 8 të Rregullores MF 4/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të datës 09.07.2021, për formim të komisionit për vlerësimin e projekteve të OJQ-ve që zhvillojnë aktivitete në fushën e thirrjes publike e cila është publikuar me datë 24.06.2021 për projektin: **“Eksplorimi i shpellave me potencial arkeologjik në komunën e Istogut”**, nxjerr:

### V E N D I M

**1. FORMOHET:** Komisioni për Vlerësimin e projekteve të OJQ-ve të cilat kanë aplikuar në thirrjen publike të datës 24.06.2021 për projektin: **“Eksplorimi i shpellave me potencial arkeologjik në komunën e Istogut”** dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Qefsere Ibrahimaj**, Zyrtare e Lartë për Trashëgimi Kulturor dhe Arkiv të Qytetit, Kryesuese e komisionit;
- 1.2. **Genc Ademaj**, Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Projekteve për Partneritet Publiko Privat, anëtar;
- 1.3. **Rexhë Mulaj**, përfaqësues i OJQ- “Vision 02” anëtar;
- 1.4. **Besnik Metaj**, Zyrtar për Tatim në Pronë, anëtar dhe
- 1.5. **Blendor Isufaj**, përfaqësues i KVRL-së, anëtar.

**2.** Komisioni i cekur me lartë ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha projekteve konkurruese të OJQ-ve-klubeve sportive të cilat kanë aplikuar në thirrjen publike të datës 24.06.2021 për projektin: **“Eksplorimi i shpellave me potencial arkeologjik në komunën e Istogut”** si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

**3.** Përgjegjësin për vlerësimin e të gjitha projekteve konkurruese të OJQ-ve për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

**4.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

**5.** Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të Vendimit të njoftohet: Komisioni, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**

*Zekije SUTAJ*



|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br.01-370/021</b>                                                          | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>09.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, shqyrtoi kërkesën Nr.08-553-14416 të datës 26.04.2021 të parashtruar nga Gazmend Mavraj nga fsh.Saradran, Komuna e Istogut, për kompensimin e demit të shkaktuar nga vërshimet dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

#### V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa Nr.08-553-14416 të datës 26.04.2021 e parashtruar nga Gazmend Mavraj, për përkrahje financiare për kompensimin e demit të shkaktuar nga vërshimet që uji i ka dëmtuar objektin e banimit mobilet shtëpiake, dhe teknikën e bardhë dhe i ndahen **2000€ (dymijë euro)** nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Gazmend Mavraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

#### A r s y e t i m

Gazmend Mavraj, ka parashtruar kërkesën Nr.08-553-14416 të datës 26.04.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për kompensimin e demit të shkaktuar nga vërshimet e që uji i ka dëmtuar mobilet shtëpiake, dhe teknikën e bardhë, po ashtu ka dëme te konsiderueshme në objektin e banimit dhe në kultura bujqësore.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron te arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni ka dal në vendin e ngjarjes ka vlerësuar demin që është bërë nga vërshimet në katin e parë të shtëpisë që uji i ka dëmtuar mobilet shtëpiake, dhe teknikën e bardhë po ashtu ka dëme te konsiderueshme në objektin e banimit dhe në kultura bujqësore, përkrahjet me mjete financiare në shumë prej **2000€ (dymijë euro)**.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake ti blejë mobilet shtëpiake dhe teknikën e bardhë.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: **Gazmend Mavraj**, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës

**Haki RUGOVA**



|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-367/2021</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>09.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja dhe në bashkëpunim me Prokurimin caktuan Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Dezinfektimi i Hapësirave Publike”, nxjerr:

## V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxher i kontratës, **Ermiona Ahmetaj**, Inspektore Sanitare dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Enver Rugova**, Drejtor i Drejtor i D.SH.P.M.SH për projektin: “Dezinfektimi i Hapësirave Publike”, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2921-2-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-017-221, të cilin është duke e realizuar grupi i operatorëve ekonomike B.I; D.D.D SH.P.K të cilin e përfaqëson Haki Bytyqi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Përgjegjësin për realizimin e projekteve të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen, **Ermiona Ahmetaj**, **Enver Rugova**, **Prokurimi**, **Grupi i operatorëve ekonomike B.I; D.D.D SH.P.K**, dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**Zekije SUTAJ**

*Zekije SUTAJ*



**Zyrtari Kryesor Administrativ**  
**z.Haki RUGOVA**

*Haki Rugova*



|                                                                                                                                                                        |                                                                                   |                                                    |                                                                                                                                                                    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                        | <b>Nr.Br. 01-<u>366</u>/021</b>                                                   | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>08.07.2021</b> |                                                                                                                                                                    |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria për Arsim shqyrtoi kërkesën Nr.05.Nr.016-16749 të datës 17.05.2021 të parashtruar nga Samir Ramić nga fsh. Lubovë, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, për fëmijun e tij Anela Ramić dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

#### V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.05.Nr.016-16749 e datës 17.05.2021, e parashtruar nga Samir Ramić për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijun e tij Anela Ramić si nxënëse e rregullt në SHFMU "Fans.S.Noli" në Llukac të Begut paralelja e ndarë Dubrushe dhe i ndahen 200 € (dyqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim si ndihmë momentale për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2021, relacioni Lubovë -Dobrush dhe anasjelltas.
2. Pagesa e mjeteve të cekura, do të bëhet nga Drejtoria për Arsim dhe të njëjtat do të transferohen në xhirollogarinë e prindit Samir Ramić, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

#### A r s y e t i m

Samir Ramić, ka parashtruar kërkesë Nr.05.Nr.016-16749 të datës 17.05.2021, me të cilën kërkesë ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për pagimin e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijun e tij Anela Ramić si nxënëse e rregullt në SHFMU "Fans.S.Noli" në Llukac të Begut paralelja e ndarë Dubrushe për gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2021.

Samir e ka gjendjen e vështir ekonomike nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kështu nuk ka mundësi me ja mbuluar shpenzimet e udhëtimit për vajzën.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të permendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik i subvencioneve dhe transverëve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë të shoqatave joqeveritare dhe individëve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogari e Samir Ramić, nga nëpunësi përgjegjës në Drejtorin për Arsim në pajtim me procedurat në fuqi.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa.

Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen nga Samir Ramić, Drejtorin për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.





|                                                                                                                                                    |                                                                                         |                                                          |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                          | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | <b>Nr.Br. 01-365/021</b>                                                                | <b>Data:<br/>         Datum:<br/>         08.07.2021</b> |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria për Arsim shqyrtoi kërkesën Nr.05.Nr.016-16746 të datës 17.05.2021 të parashtruar nga Hazra Huremoviç nga fsh. Lubovë, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, për fëmijët e saj Elda,Ermin,Maida Šabotić dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

#### V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.05.Nr.016-16746 e datës 17.05.2021, e parashtruar nga Hazra Huremoviç për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijët e saj Elda,Ermin,Maida Šabotić si nxënës të rregullt në SHFMU "Fans.S.Noli" në Llukac të Begut paralelja e ndarë Dubrushe dhe i ndahen 200 € (dyqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim si ndihmë momentale për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2021, relacioni Lubovë -Dobrush dhe anasjelltas.
2. Pagesa e mjeteve të cekura, do të bëhet nga Drejtoria për Arsim dhe të njëjtat do të transferohen në xhirollogarinë e nënës Hazra Huremoviç , në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

#### A r s y e t i m

Hazra Huremoviç , ka parashtruar kërkesë Nr.05.Nr.016-16746 të datës 17.05.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për pagimin e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijët e saj Elda,Ermin,Maida Šabotić si nxënës të rregullt në SHFMU "Fans.S.Noli" në Llukac të Begut paralelja e ndarë Dubrushe për gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2021.

Hazra e ka gjendjen e vështir ekonomike nuk ka asnjë burim të rregull të të ardhurave dhe kështu nuk ka mundësi me ja mbuluar shpenzimet e udhëtimit për fëmijet.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik i subvencioneve dhe transverëve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë të shoqatave joqeveritare dhe individëve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogari e Hazra Huremoviç , nga nëpunësi përgjegjës në Drejtorinë për Arsim në pajtim me procedurat në fuqi.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen nga Hazra Huremoviç, Drejtoria për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



|                                                                                                                                                   |                                                                                          |                               |                                                                                                                                               |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠHTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                   | Nr.Br. 01- <u>364</u> /021                                                               | Data:<br>Datum:<br>08.07.2021 |                                                                                                                                               |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria për Arsim shqyrtoi kërkesën Nr.05.Nr.016-16748 të datës 17.05.2021 të parashtruar nga Samir Gugać nga fsh. Lubovë, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, për fëmijun e tij Adem Gugać dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

## V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.05.Nr.016-16748 e datës 17.05.2021, e parashtruar nga Samir Gugać për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijun e tij Adem Gugać si nxënëse i rregullt në SHFMU "Fans.S.Noli" në Llukac të Begut paralelja e ndarë Dubrushe dhe i ndahen 200 € (dyqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim si ndihmë momentale për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2021, relacioni Lubovë -Dobrush dhe anasjelltas.
2. Pagesa e mjeteve të cekura, do të bëhet nga Drejtoria për Arsim dhe të njëjtat do të transferohen në xhirollogarinë e prindit Samir Gugać, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

## A r s y e t i m

Samir Gugać, ka parashtruar kërkesë Nr.05.Nr.016-16748 të datës 17.05.2021, me të cilën kërkesë ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për pagimin e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijun e tij Adem Gugać si nxënëse i rregullt në SHFMU "Fans.S.Noli" në Llukac të Begut paralelja e ndarë Dubrushe për gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2021.

Samir e ka gjendjen e vështir ekonomike nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kështu nuk ka mundësi me ja mbuluar shpenzimet e udhëtimit për djalë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të permendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik i subvencioneve dhe transvereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë të shoqatave joqeveritare dhe individëve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogari e Samir Gugać, nga nëpunësi përgjegjës në Drejtorinë për Arsim në pajtim me procedurat në fuqi.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen nga Samir Gugać, Drejtorin për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



|                                                                                                                                                   |                                                                                    |                               |                                                                                                                                               |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSIEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                   | Nr.Br. 01- <u>363</u> /021                                                         | Data:<br>Datum:<br>08.07.2021 |                                                                                                                                               |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria për Arsim shqyrtoi kërkesën 05.Nr.553-4652 të datës 04.02.2021 të parashtruar nga Lendita Hajdinaj nga fsh. shushicë, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për vajzën, Adelina dhe Albisona Hajdinaj, dhe i propozoj Kryetarit të nxjerri:

### V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 05.Nr.553-4652 e datës 04.02.2021, e parashtruar nga Lendita Hajdinaj për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për vajzat dhe i ndahen 300 € (treqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim si ndihmë momentale për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për gjysmëvjetorin e dytë shkollor të vitit 2021, për vijimin në shkollën speciale në Pejë.
2. Paga e mjeteve të cekura, do të bëhet nga Drejtoria për Arsim dhe të njëjtat do të transferohen në xhirollogarinë e Lendita Hajdinaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

Lëndita Hajdinaj, ka parashtruar kërkesën 05.Nr.553-4652 të datës 04.02.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet ndihmë momentale financiare për pagimin e shpenzimeve të udhëtimit për vajzat Adelina dhe Albisona Hajdinaj, për gjysmëvjetorin e dytë të vitit 2021, të cilat janë nxënëse të rregullt në shkollën speciale në Pejë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Adelina dhe Albisona Hajdinaj, janë me të shikuar të dobësuar dhe të njëjtat vijnë në mesimet në shkollën speciale në Pejë tri ditë në javë në relacionin Shushicë-Pejë dhe anasjelltas me shoqërues.

Lendita është e pa punë, përveq ndihmës sociale e ka gjendjen e vështirë ekonomike nuk ka burim tjetër të rregullt të të ardhurave dhe kështu nuk ka mundësi t'i mbulojë shpenzimet e udhëtimit për vajzat e saj.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik i subvencioneve dhe transverëve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë të shoqatave joqeveritare dhe individëve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogari të përmendures nga nëpunësi përgjegjës në Drejtorinë për Arsim në pajtim me procedurat në fuqi.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Lendita Hajdinaj, Drejtoria për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.





|                                                                                                                                                    |                                                                                  |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-362/021                                                                | Data:<br>Datum:<br>07.07.2021 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin dy vjeçar: Lot2 “Ndërtimi i rrugëve në Tomoc” me numër të jashtëm prokurimi 633-20-4834-5-2-1/ C404 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-020-065-521 dhe nxjerr:

## V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për verifikimin e punëve për projektin dy vjeçar: Lot2 “Ndërtimi i rrugëve në Tomoc” me numër të jashtëm prokurimi 633-20-4834-5-2-1/ C404 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-020-065-521 të cilin e ka realizuar në vitin 2020 **operatori GOE “BENITA COMPANY”& “ASFALT GROUP” SH.P.K,** të cilin e përfaqëson z.Emin Demaku, nga Komuna e Klinës, dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Blerim Bujupi**, Zyrtar për Ndërtimtar, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. **Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar dhe;
- 1.3. **Përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit.**

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj mbikëqyrësin e punimeve, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartëcekur; do të hartojë procesverbalin për verifikimin e punimeve si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Komisioni, Prokurimi, operatori GOE “BENITA COMPANY”& “ASFALT GROUP” SH.P.K, CONSTRUCTION SH.P.K,** Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**




Kryetari i Komunës  
**z.Haki RUGOVA**





|                                                                                                                                                    |                                                                                  |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-361/021                                                                | Data:<br>Datum:<br>07.07.2021 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin dy vjeçar: Lot3 "Asfaltimi i rrugës në Cerrcë" me numër të jashtëm prokurimi 633-20-4834-5-2-1/ C405 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-020-065-521 dhe nxjerr:

## V E N D I M

- 1. FORMOHET:** Komisioni për verifikimin e punëve për projektin dy vjeçar: Lot3 "Asfaltimi i rrugës në Cerrcë" me numër të jashtëm prokurimi 633-20-4834-5-2-1/ C405 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-020-065-521 të cilin e ka realizuar në vitin 2020 **operatori "BK-CONSTRUCTION SH.P.K"**, të cilin e përfaqëson z. Kreshnik Muriqi, nga Komuna e Pejës, dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Blerim Bujupi**, Zyrtar për Ndërtimtar, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. **Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar dhe;
- 1.3. **Përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit.**

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj mbikëqyrësin e punimeve, do të njoftoj Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; do të hartojë procesverbalin për verifikimin e punimeve si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Komisioni, Prokurimi, operatori "B.K"-CONSTRUCTION SH.P.K**, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**




Kryetari i Komunës  
**z.Haki RUGOVA**



|                                                                                                                                                    |                                                                                         |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosovo | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-360/021                                                                       | Data:<br>Datum:<br>07.07.2021 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin dy vjeçar: Lot1 "Asfaltimi i rrugës në Llukavc të Thatë" me numër të jashtëm prokurimi 633-20-4834-5-2-1/ C403 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-020-065-521 dhe nxjerr:

## V E N D I M

- 1. FORMOHET:** Komisioni për verifikimin e punëve për projektin dy vjeçar: Lot1 "Asfaltimi i rrugës në Llukavc të Thatë" me numër të jashtëm prokurimi 633-20-4834-5-2-1/ C403 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-020-065-521 të cilin e ka realizuar në vitin 2020 **operatori "BK-CONSTRUCTION SH.P.K"**, të cilin e përfaqëson z. Kreshnik Muriqi nga Komuna e Pejës, dhe në komision caktohen:

- 1.1. Blerim Bujupi**, Zyrtar për Ndërtimtar, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar dhe;
- 1.3. Përfaqësuesi** nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit.

**2.** Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj mbikëqyrësin e punimeve, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartëcekur; do të hartojë procesverbalin për verifikimin e punimeve si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

**3.** Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

**4.** Vendimi është perfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Komisioni, Prokurimi, operatori "B.K"-CONSTRUCTION SH.P.K**, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**Zekije SUTAJ**

*[Signature]*



**Kryetari i Komunës**  
**Haki RUGOVA**

*[Signature]*

|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-359/2021</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>07.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Mirëmbajta e ndriçimit publik në Komunën e Istogut” me numër të jashtëm prokurimi 633-021-3647-2-2-1 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-026-221, nxjerr:

## V E N D I M

**1. THEMELOHET:** Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Mirëmbajta e ndriçimit publik në Komunën e Istogut” me numër jashtëm prokurimi 633-021-3647-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-026-221 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Naser Nimanaj,** Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Isa Hoxhaj** inxhinier i makinerisë-Zyrtar i Lartë për Eficiencë të Energjisë, anëtar dhe
- 1.3. Blerim Bujupi,** Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar.

**2.** Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Mirëmbajta e ndriçimit publik në Komunën e Istogut” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.


**3.** Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

**4.** Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

**5.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**Zekije SUTAJ**







|                                                                                                                                                    |                                                                                   |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosovo | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSIEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-358/021                                                                 | Data:<br>Datum:<br>07.07.2021 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) shqyrtoj kërkesën 09 Nr.11/2021 të datës 07.07.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për përkrahje të bletarëve me shoqëri bletësh, nxjerr:

### V E N D I M

**1. THEMELOHET:** Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për përkrahje të bletarëve me shoqëri bletësh dhe në Komision caktohen:

- 1.1. **Valbone Kaliqani**, Zyrtare e Lartë për Pemëtari, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. **Xhevat Idrizaj**, Zyrtar për Pylltari 2, anëtar dhe
- 1.3. **Jeton Sylaj**, Zyrtar për aplikime në pagesa direkte (Subvencione).

2. Komisioni i lartcekur obligohet që ti shqyrtoj të gjitha kërkesat e bletarëve që kanë kërkuar të përkrahen me shoqëri bletësh; të përpilojë listën e ngushtë përfituesve; përfituesve t'ju bëjë shpërndarjen e shoqërive të bletëve si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do ti kryejë Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe shfuqizohet Vendimi 01 Nr.574/2020 i datës 01.10.2020.

5. Për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

Me kopje të këtij Vendim do të njoftohen: Komisioni, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**



Kryetari i Komunës  
**Haki RUGOVA**



|                                                                                                                                                                         |                                                                                   |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-357/021</b>                                                          | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>07.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) shqyrtoj kërkesën 09 Nr.09/2021 të datës 06.07.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për themelimin e Komisionit për dalje në vendin e ngjarjes për vlerësimin e dëmit të shkaktuara nga zjarri që janë djegur shtallat e bagëtive, nxjerr:

## V E N D I M

**1.THEMELOHET:** Komisioni për dalje në vendin e ngjarjes për vlerësimin e dëmit të shkaktuara nga zjarri që janë djegur shtallat e bagëtive, dhe në Komision caktohen:

- 1.1. Skender Hasangjekaj,** Udhëheqës i Sektorit për Siguri dhe Emergjencë, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Valbone Kalijani,** Zyrtare e Lartë për Pemëtari, anëtare dhe
- 1.3. Blerim Bujupi,** Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar.

**2.** Komisioni i lartcekur obligohet të dalë në vendin e ngjarjes dhe të bëjë vlerësimin me procesverbal të dëmit të shkaktuara nga zjarri që janë djegur shtallat e bagëtive, të bëjë foto në vendin e ngjarjes si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjerë të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

**3.** Të gjitha punët tekniko-administrative për nevojat e komisionit do të kryejë Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

Me kopje të këtij Vendim do të njoftohen: Komisioni, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**Zekije SUTAJ**





|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-356/021</b>                                                         | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>07.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13, nenin 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.11 të datës 07.07.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për formim të Shtabit Komunal për realizimin me sukses të korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Istogut dhe nxjerr:

### V E N D I M

1. **FORMOHET:** Shtabit Komunal për korrje-shirje për realizimin me sukses të korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Istogut dhe në Shtab caktohen:
  - 1.1. **Lulzim Shoshi**, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, Kryesues i Shtabit Komunal;
  - 1.2. **Fsadil Kabashi**, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, anëtar;
  - 1.3. **Skender Hasangjekaj**, Udhëheqës i Sektorit për Siguri dhe Emergjencë, anëtar;
  - 1.4. **Rasim Mahmutovic**, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
  - 1.5. **Valbone Kalijani**, Zyrtare e Lartë për Pemëtari, anëtare;
  - 1.6. **Haki Belaj**, Inspektor për Parandalimin nga Zjarri, anëtar dhe
  - 1.7. **Jeton Sylaj**, anëtar.
2. Shtabi për korrje-shirje obligohet të përcjell fushatën e korrje-shirjeve në tërë territorin e komunës; do të kujdeset që korrje-shirjet të realizohen me sukses dhe në afat; të gjitha mosmarrëveshjet në mes të kornjerve dhe fermerëve të zgjidhin me marrëveshje në mënyrë paqësore; të njoftoj rregullisht Kryetarin me ecurin e fushatës së korrje-shirjeve si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjerë të cilat janë në natyrën e këtij Shtabi Komunal.
3. Të gjitha punët administrative-teknike për nevojat e Shtabit do të kryejë Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Shtabi Komunal dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

Me kopje të këtij vendimi njoftohen: Shtabi Komunal dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

**Zekije SUTAJ**






|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-354/2021</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>06.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Lot1“Renovimi i dysHEMEVE në Gjumnazin Haxhi Zeka në Istog”, Lot2 “Ndërtimi i depove për dru në dy Institucione shkollore”, Lot3“Ndërtimi i dyerve dhe dritareve në objektin shkollor Hysni Zajmi Vrellë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-3716-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-027-521, nxjerr:

## V E N D I M

**1. FORMOHET:** Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Lot1“Renovimi i dysHEMEVE në Gjumnazin Haxhi Zeka në Istog”, Lot2 “Ndërtimi i depove për dru në dy Institucione shkollore”, Lot3“Ndërtimi i dyerve dhe dritareve në objektin shkollor Hysni Zajmi Vrellë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-3716-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-027-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Naim Sadriu,** Zyrtar për Standarde, Vlerësim dhe Monitorim, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Brahim Bytyqi,** Drejtorë në Gjumnazin “Haxhi Zeka”, anëtar dhe
- 1.3. Shkelqim Blakaj,** Sekretar i SHFMU “Hysni Zajmi në Vrellë”, anëtar.

**2.** Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektet: Lot1“Renovimi i dysHEMEVE në Gjumnazin Haxhi Zeka në Istog”, Lot2 “Ndërtimi i depove për dru në dy Institucione shkollore”, Lot3“Ndërtimi i dyerve dhe dritareve në objektin shkollor Hysni Zajmi Vrellë”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

**3.** Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

**4.** Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

**5.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria Komunale për Arsim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria Komunale për Arsim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



**Kryetari i Komunës**  
**Haki RUGOVA**

|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-351/2021</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>05.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja dhe në bashkëpunim me Prokurimin caktuan Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektet: Lot1 “Renovimi i objektit shkollor dhe infrastrukturës në SHFMU Martin Camaj-paralelja e ndarë në Llukafç të Thate”; Lot2 “Renovimi i objektit shkollor dhe infrastrukturës në SHFMU Fan Noli-paralelja e ndare në Dobrushë”, nxjerr:

## V E N D I M

**1. CAKTOHET:** Menaxher i kontratës, **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Hajrush Shoshi**, Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim për projektet: Lot1 “Renovimi i objektit shkollor dhe infrastrukturës në SHFMU Martin Camaj-paralelja e ndarë në Llukafç të Thate”; Lot2 “Renovimi i objektit shkollor dhe infrastrukturës në SHFMU Fan Noli-paralelja e ndare në Dobrushë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-1310-5-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-010-521, projektin Lot 1 e ka fituar për ta realizuar Grupi operatorëve ekonomik “Dardanija Group” SH.P.K; GREEN CONSTRUCTION SH.P.K, dhe për projektin Lot2 e ka fituar operatori AXIS “G.CW” SH.P.K.

**2.** Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

**3.** Përgjegjësin për realizimin e projekteve të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

**4.** Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**5.** Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Naser Gjocaj**, **Hajrush Shoshi**, “Dardanija Group” SH.P.K; GREEN CONSTRUCTION SH.P.K, dhe AXIS “G.CW” SH.P.K.dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**Zekije SUTAJ**





**Zyrtari Kryesor Administrativ**  
**z.Haki RUGOVA**



|                                                                                   |                                                                       |                                        |                                                                                    |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|
|  | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                        |  |
| <b>Republika e Kosovës<br/>Republika Kosovo<br/>Republic of Kosova</b>            | <b>Nr.Br. 01-350/2021</b>                                             | <b>Data:<br/>Datum:<br/>05.07.2021</b> | <b>Komuna e Istogut<br/>Opština Istok<br/>Istog Municipality</b>                   |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-23909, të datës 29.06.2021, e parashtruar nga z.Aldaid Haziraj, nga fsh.Studenicë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

### V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-553-23909, të datës 29.06.2021, e parashtruar nga z.Aldaid Haziraj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Aldaid Haziraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiive.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

z.Aldaid Haziraj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-23909, të datës 29.06.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Aldaid Haziraj, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Aldaid Haziraj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Aldaid Haziraj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.





|                                                                                                                                                   |                                                                                         |                               |                                                                                                                                               |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                   | Nr.Br. 01-349/2021                                                                      | Data:<br>Datum:<br>05.07.2021 |                                                                                                                                               |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-24230, të datës 01.07.2021, të parashtruar nga znj.Leonita Madanaj, nga fsh.Saradran, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënës së saj në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-24230, të datës 01.07.2021, e parashtruar nga znj.Leonita Madanaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënës së saj në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore (Kimioterapisë)dhe i lejohen 200 litra karburant.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë znj.Leonita Madanaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

### A r s y e t i m

znj.Leonita Madanaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-24230, të datës 01.07.2021, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se znj.Zyra Januzaj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë.

E lartpërmendura nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për ë Prishtinë për marrjen e terapisë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: znj. znj.Leonita Madanaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


**Kryetari i Komunës**  
**Haki RUGOVA**



|                                                                                                                                                    |                                                                                         |                               |                                                                                                                                               |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-348/021                                                                       | Data:<br>Datum:<br>05.07.2021 |                                                                                                                                               |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-24131, të datës, 30.06.2021 e parashtruar nga z.Shaban Shpatollaj, nga fsh.Muzhevinë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

### V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-24131, të datës 30.06.2021, e parashtruar z.Shaban Shpatollaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 450€(katërqindë e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Driton Shpatollaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra komunale për komunitete dhe kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

z.Shaban Shpatollaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-24131, të datës 30.06.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim te tij.  
 Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Shaban Shpatollaj, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim. Në plan programin buxhetor të Zyrës komunale kthim dhe komunitete, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësiave buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Driton Shpatollaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike. Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Shaban Shpatollaj, Zyra komunale për komunitete dhe kthim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës  
 Haki RUGOVA



|                                                                                                                                                   |                                                                                       |                               |                                                                                                                                                |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PRESDENIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                   | Nr.Br. 01-347/021                                                                     | Data:<br>Datum:<br>05.07.2021 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-1293, të datës, 12.01.2021 e parashtruar nga z.Ramo Morina, nga fsh.Serbobran, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

### V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-1293, të datës 12.01.2021, e parashtruar z.Ramo Morina, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Ramo Morina, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra komunale për komunitete dhe kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

z.Ramo Morina, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-1293, të datës 12.01.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim të tij.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Ramo Morina, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës komunale kthim dhe komunitete, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Ramo Morina, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Ramo Morina, Zyra komunale për komunitete dhe kthim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës  
 Haki RUGOVA



|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-346/2021</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>02.07.2021</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237; Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, dhe në bashkëpunim me Prokurimin caktuan Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektet: Lot1 "Ndertimi i kanalizimit në fsh. Kërrninë të Epërme"; Lot2 "Vazhdimi i Kanalizimit në fsh. Lubovë për lidhje me impiantit ekzistues"; Lot3 "Ndërtimi i kanalizimit në fsh. Kosh"; Lot4 "Ndërtimi i kanalizimit në fsh. Carrallukë"-faza e II, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2358-521 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-018-521,, nxjerr:

## V E N D I M

**1. CAKTOHET:** Grupi i Menaxhereve të kontratës si me poshtë:

- 1.1. Naser Gjocaj,** Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, Kryesues i Grupit;
- 1.2. Dukaxhin Hoxhaj,** Zyrtar për Regjistrimin e Adresave, anëtar dhe
- 1.3. Hekuran Rugova,** anëtar.

**2. CAKTOHET:** Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Enver Rugova**, Drejtor i D.SH.P.M.SH për projektet: Lot1 "Ndertimi i kanalizimit në fsh. Kërrninë të Epërme" të cilin është duke e realizuar operatori "ARBENS GARTEN PARADISE" N.N.T nga Komuna e Istogut; Lot2 "Vazhdimi i Kanalizimit në fsh. Lubovë për lidhje me impiantit ekzistues" të cilin është duke e realizuar operatori "AXSIS G.C.W" SH.P.K ; Lot3 "Ndërtimi i kanalizimit në fsh. Kosh" të cilin është duke e realizuar operatori CNSTRUCTION GROUP" SH.P.K; Lot4 "Ndërtimi i kanalizimit në fsh. Carrallukë"-faza e II të cilin është duke e realizuar grupi i operatorëve ekonomik "LURN" SH.P.K, PRO&CO GROUP, SH.P.K, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2358-521 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-018-521.

**3.** Grupi i Menaxhereve të kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Grupit të Menaxhereve të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës me 4 loto duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

**4.** Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Grupi i Menaxhereve të kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Grupit të Menaxhereve të kontratës.

**5.** Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**6.** Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Grupi i Menaxhereve të kontratës, Enver Rugova**, operatori "ARBENS GARTEN PARADISE" N.N.T, operatori "AXSIS G.C.W" SH.P.K, operatori CNSTRUCTION GROUP" SH.P.K, "LURN" SH.P.K, PRO&CO GROUP, SH.P.K dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
**Zekije SUTAJ**



  
**Zyrtari Kryesor Administrativ**  
**z.Haki RUGOVA**  
